



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Durrës më 19.01.2022

**RAPORT**

**PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E  
VITIT 2021**

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Durrës mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli si më poshtë:

1. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore“
3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”
5. Ligji nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”
6. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”
7. Ligji nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”

8. Ligji nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”
9. Ligji nr. 146, datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
10. Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
11. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
12. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”
13. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
14. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”
15. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”,i ndryshuar
16. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
17. Ligji nr. 138, datë 17.12. 2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushetrojnë Funksione Publike”. 19. Ligji nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, i ndryshuar
18. Rregullore e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, me Vendim nr.25, datë 29.04.2020
19. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak”, me Vendim nr.25, datë 29.04.2020
20. Rregullore për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median, me Vendim nr.90, datë 30.09.2020
21. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare, me Vendim nr. 103, datë 30.10.2020

Edhe viti që kaluam ashtu sikur dhe viti para tij kanë qenë tepër sfidues, pasi përhapja e virusit Covid-19, detyroi përshtatjen me një realitet krejtësisht tjetër. U ridimensionuan plotësisht si marrëdhëniet ekonomike shoqërore edhe ato të të punuarit apo ato të komunikimit në rafshin profesional dhe individual, kështu që Këshilli Bashkiak Durrës ka marrë masa dhe gjatë vitit 2021 për tu përshtatur më këtë qasje të re, duke garantuar vazhdimësinë dhe mirëfunksionimin e aktivitetit të këshillit si dhe përmbushjen rigorozë të detyrimeve ligjore.

Këshilli i Bashkisë Durrës, gjatë 12-mujorit të vitit 2021 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. Shqyrtimi dhe miratimi më i madh i vendimeve i kushtoheshin procesit të rindërtimit pas tërmetit të datës 26.11.2019, por gjithashtu ka marrë dhe vendime, që i kushtoheshin familjeve me probleme të thella sociale.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë :

<b>Nr.</b>	<b>Muaji</b>	<b>Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë</b>	<b>Ndihmë ekonomike për familje nga fondi i kushtëzuar 6 %</b>
1.	Janar	87	2
2.	Shkurt	91	9

3.	Mars	91	12
4.	Prill	93	17
5.	Maj	91	19
6.	Qershor	87	19
7.	Korrik	86	19
8.	Gusht	89	18
9.	Shtator	91	18
10.	Tetor	94	20
11.	Nëntor	94	22
12.	Dhjetor	90	23

Kemi akorduar bonus strehimi për familjet që përmbushnin kriteret ligjore për të përfituar këtë bonus të akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise në favor të Bashkisë Durrës, gjithsej 92 familje me VKB. Nr.39 dhe 107 familje me VKB. Nr.126 (ku përmendim invalidë, persona PAK, familje të komunitetit egjiptian ose rom, persona që gëzojnë statusin e jetimit, apo kryefamiljare të divorcurara).

Kemi akorduar ndihmë financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet për Nj.Administrative Sukth dhe Katund i Ri si dhe Njësia Administrative nr.6

*Në zbatim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 Këshilli i Bashkisë Durrës, ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2021 si,*

- për subvencionimin e qirasë për familje që mbetën të pastreha nga tërmeti apo që mbetën të pastreha nga prishja e detyruar e pallateve pranë tyre,
- për përfituesit nga granti i rindërtimit për banesat e klasifikuara me dëmin ds1, ds2 dhe ds3, (lista e 9 deri lista e 12),
- për përfituesit nga programi i rindërtimit për banesat e klasifikuara me dëmin ds4 dhe ds5, (riforcim e prishje)
- për përfitues të masës së grantit të rindërtimit të banesave individuale, sipas projektit model (lista 1 deri lista 8).
- gjithashtu janë marrë 9 vendime për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkatuar nga tërmeti, në zbatim të ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit.

Duhet përmendur se subvencionimi i qirasë është dhënë dhe për familjet të mbetura të pastreha si pasojë e shëmbjes së banesave të tyre në zbatim të projektit të rindërtimit sheshi DYZH, zona 4 Durrës -Spitallë.

*Këshilli ka marrë, deri me datë 23.12.2021, 10 (dhjetë) vendime për miratim të prishjes së detyruar të disa pronave të Bashkisë Durrës, pasi kanë rezultuar të rrezikshme për jetën dhe shëndetin pas tërmetit të nëntorit sipas ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit Tiranë dhe janë rekomanduar të shëmben, si vijon:*

- korrik - 1 godinë, shkolla mesme “Dhori Liperi” Nj. Administrative Sukth me VKB nr.95
- gusht - 1 godinë, kopshti “Isuf Ferra”, Durrës me VKB nr.100
- gusht - 1 godinë, shkolla mesme (Kuçok), Nj. Administrative Manëz me VKB nr.101
- gusht - 1 godinë, shkolla 9 vjeçare Vadardhë, Nj. Administrative Sukth me VKB nr.102
- shtator - 1 godinë, shkolla e mesme përgjithshme “Naim Frashëri”, Durrës  
me VKB nr.108
- shtator - 1 godinë, shkolla fillore,cikli ulët (kopsht), Bizë, Nj. Administrative Ishëm  
me VKB nr.109
- shtator - 1 godinë, shkolla 9 vjeçare dhe kopshti “Eftali Koçi”, Durrës  
me VKB nr.110
- shtator - 1 godinë, shkolla e mesme përgjithshme “Gjergj Kastrioti”, Durrës  
me VKB nr.111
- shtator - 1 godinë, shkolla e mesme profesionale “Benardina Qeraxhi”, Durrës  
me VKB nr.112
- shtator - 1 godinë, shkolla e mesme përgjithshme “Olsi Lasku”, Durrës me VKB nr.113

*Këshilli ka marrë 5 vendime për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të pronave private, dhe 1 vendim për shfuqizim, sipas akt ekspertizave të thelluara të Institutit Ndërtimit, Tiranë si vijon :*

- Në janar – 3 objekte pronë private njësia administrative nr.3, nr.4 (VKB nr. 4)
- Në shkurt – 1 objekt pronë private njësia administrative nr.4  
(VKB.nr.23, shfuqizuar me VKB nr. 99, datë 31.08.2021)
- Në mars – 1 objekt pronë private njësia administrative nr.5 (VKB.nr.31)
- Në qershor – 1 objekt pallat 25/1, rruga Hysen Myshketa (VKB nr.73)
- Në korrik – 1 objekt pallat, rruga Gjon Kastrioti, njësia administrative Rrashbull  
(VKB.nr.90)

*Krahas këtyre vendimeve kemi miratuar vendime për :*

- Për vendndodhjen e terminalit jugor të autobuzëve në Bashkinë Durrës. (VKB nr.9)
- Miratim përdorim fondi të alokuara nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor. (VKB nr.36)
- Miratimin e linjave qytetase të transportit publik, intinerarin, stacionet, dhe oraret e tyre.  
(VKB nr.53)
- Ka miratuar fond për rimbursimin e shpenzimeve të volejbollistes Pamela Mehja .  
(VKB nr.58)
- Rialokim fondi prej 372.080 lekë për shërbimin në familje për fëmijë me aftësi të kufizuara

- të moshës 2-6 vjeç . (VKB nr.62)
- Miratim i zonave të destinuar për parkim në qytetin e Durrësit . (VKB nr.83)
  - Shtesë dhe ndryshime të buxhetit për vitin 2021 me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve financiare.
  - Miratim të zgjidhjes së detyrës së projektimit të rehabilitimit të infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën Porto Romano -Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit Durrës. (VKB nr.87)
  - Miratimin e 345 familjeve përfituesve të programit të kredisë të lehtësuar për strehim me 3% interes. (VKB nr.131)
  - Përcaktimin e mënyrës dhe rregullave për faljen e masave administrative me karakter ndërshkues të vendosur nga bashkia për perudhën 23 shtator-tetor, ndaj familjeve të dëmtuara nga tërmeti i nëntorit. (VKB nr.134)
  - Buxhetin e vitit 2022 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2022-2024. (VKB nr.158)
  - Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2022. (VKB nr.160)
  - Bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar, profesional dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale, për vitin shkollor 2021-2022. (VKB nr.162 dhe 163)
  - Vendimet për emergjencat civile kanë lidhje me miratimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga prishja e detyruar e objekteve pranë tyre të dëmtuara nga tërmeti si dhe miratimi përdorimi i fondit i përfituar nga qeverisja qendrore si mbështetje financiare për menaxhimin e mbetjeve.
  - Gjithashtu Këshilli ka marrë dhe disa vendime që i përkasin mbarëvajtjes së punës së tij.

**Për periudhën janar – dhjetor 2021, janë marrë 166 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Durrës.**

*(Bashkëngjitur materialit gjeni dosjen e vendimeve ku është përcaktuar saktë numri i vendimit, data e vendimit, data e shpalljes së vendimit, titulli i vendimit, data e miratimit nga Prefekti dhe nr.i fletëve të vendimit dhe dokumentave shoqëruese të tij, të cilat janë të publikuara dhe në faqen e internetit të Këshillit)*

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2021 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra.

Nga Prefektura Durrës është kryer kontroll sipas legjislacionit dhe në raportin përfundimtar të datës 15.10.2021 është cilësuar se Këshilli Bashkiak Durrës ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore dhe rekomandon rishikimin e rregullores në lidhje me procedurën on-line apo dhe problematika të tjera të hasura gjatë punës në vijim si dhe shtesë personeli në Sekretariatit e Këshillit për të bërë të mundur në këtë mënyrë zbatimin e rregulloreve që ka miratuar 2 vitet e

fundit.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Durrësit.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë aktiv, duke mbajtur mbledhje të radhës, mbledhje jashtë radhe dhe mbledhje të jashtëzakondshme, sipas tabelës së mëposhtëme :

<b>Muaji</b>	<b>Nr i mbledhjeve</b>	<b>Mbledhje të radhës</b>	<b>Mbledhje jashtë radhe</b>	<b>Mbledhje të jashtëzakondshme</b>
Janar	1	1 (28.01.2021)	-	-
Shkurt	4	1 (25.02.2021)	1 (22.02.2021)	2 (04.02.2021,05.02.2021)
Mars	3	1 (31.03.2021)	2 (05.03.2021;26.03.2021)	-
Prill	2	-	2 (14.04.2021,20.04.2021)	-
Maj	1	1 (24.05.2021)	-	-
Qershor	2	1 (28.06.2021)	1 (10.06.2021)	-
<b>Total 6 mujor parë</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
Korrik	2	1 (26.07.2021)	1 (12.07.2021)	-
Gusht	2	1 (31.08.2021)	-	1 (04.08.2021)
Shtator	1	1 (30.09.2021)	-	-
Tetor	1	1 (28.10.2021)	-	-
Nëntor	2	1 (25.11.2021)	1 (12.11.2021)	-
Dhjetor	3	1 (23.12.2021)	2 (06.12.2021;17.12.2021)	-
<b>Total 6 mujor dytë</b>	<b>11</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>1</b>

<b>Periudha</b>	<b>Nr i mbledhjeve</b>	<b>Mbledhje të radhës</b>	<b>Mbledhje jashtë radhe</b>	<b>Mbledhje të jashtëzakondshme</b>
6 mujori parë	13	5	6	2
6 mujori dytë	11	6	4	1
<b>Total 12 mujori</b>	<b>24</b>	<b>11</b>	<b>10</b>	<b>3</b>

*Kalendari i zhvillimit të mbledhjeve paraqitet si më poshtë :*

<b>Nr.</b>	<b>DATA E MBLEDHJES</b>	<b>ORA</b>	<b>VENDI I ZHVILLIMIT</b>
1.	28.01.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
2.	04.02.2021	11:00	Aplikacioni SKYPE
3.	05.02.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
4.	22.02.2021	10:00	Aplikacioni SKYPE
5.	25.02.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
6.	05.03.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
7.	26.03.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
8.	31.03.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
9.	14.04.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
10.	20.04.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
11.	24.05.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
12.	10.06.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
13.	28.06.2021	12:00	Salla e QK “Aleksandër Moisiu”
14.	12.07.2021	11:00	Aplikacioni SKYPE
15.	26.07.2021	12:00	Salla e QK “Aleksandër Moisiu”
16.	04.08.2021	17:00	Aplikacioni SKYPE
17.	31.08.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
18.	30.09.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
19.	28.10.2021	12:00	Salla e QK “Aleksandër Moisiu”
20.	12.11.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
21.	25.11.2021	12:00	Salla e QK “Aleksandër Moisiu”
22.	06.12.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
23.	17.12.2021	12:00	Aplikacioni SKYPE
24.	23.12.2021	12:00	Salla e QK “Aleksandër Moisiu”

Siç shihet dhe nga kalendari i mbledhjeve gjatë muajit janar-dhjetor 2021, 19 (nëntëmbëdhjetë) mbledhje të Këshillit janë zhvilluar online për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, përveç 5(pesë) mbledhjeve, ku Këshilli ka mbajtur senacën plenare në sallën e Qendrës Kulturore

“Aleksandër Moisiu” (duke zbatuar protokollin e sigurisë së institucionit, për masat e marra kundër Covid – 19, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).

Vlen për tu përmendur se pjesëmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online.

Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projektvendimet e sjella nga administrata e Bashkisë Durrës. Për periudhën 12-mujore janë bërë 121 mbledhje të komisioneve të përhershëm, pjesa më e madhe prej tyre janë mbajtur online në kushtet e pandemisë.

<b>Nr.</b>	<b>Muaji</b>	<b>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm</b>
1.	Janar	6
2.	Shkurt	14
3.	Mars	16
4.	Prill	10
5.	Maj	7
6.	Qershor	12
	<b>Total 6 mujori I-rë</b>	<b>65</b>
7.	Korrik	8
8.	Gusht	11
9	Shtator	6
10	Tetor	7
11	Nëntor	11
12	Dhjetor	13
	<b>Total 6 mujori II-të</b>	<b>56</b>
	<b>TOTALI 12 MUJOR</b>	<b>121</b>

Në çdo rast Komisionet e Përhershme në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës” kanë mbajtur raportin përfundimtar ku pasqyrohet vendimmarrja e secilit komision për pikat e rendit të ditës, që u janë caktuar për t’i shqyrtuar, sipas tabelës së mëposhtëme:

<b>Nr.</b>	<b>Komisioni</b>	<b>6 mujori parë 2021 RAPORTE E PROCESVERBALE TË KOMISIONEVE sipas pikave të rendit të ditës</b>



		<i>Janar</i>	<i>Shkurt</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qershor</i>
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	5	9	13	8	1	1p+2r
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	1	2	7	-	-	2
3.	Komisioni Mandateve	1 p	-	-	-	1	-
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	3	6	13	4	1	1p+2r
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	-	5	6	6	2	8
6.	Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	1	-	1	1	-
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	-	1	1	1	1	2
8.	Komisioni i Mardhënieve me Jashtë	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	-	1	-	-	1
10.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale	2	1	-	2	2	1
11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	1	-	1	1	-	1
12.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	1	-	-	1
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	-	1	-	-	
14.	Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
	<b>Totali – 136</b>	<b>13</b>	<b>25</b>	<b>44</b>	<b>23</b>	<b>9</b>	<b>22</b>

<i>Nr.</i>	<i>Komisioni</i>	<i>6 majori dytë 2021</i> <i>RAPORTE E PROÇESVERBALE TË KOMISIONEVE</i> <i>sipas pikave të rendit të ditës</i>					
		<i>Korrik</i>	<i>Gusht</i>	<i>Shtator</i>	<i>Tetor</i>	<i>Nëntor</i>	<i>Dhjetor</i>
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	4	2	10	12	1p	6
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	3	2	2	2	1	2
3.	Komisioni Mandateve	-	-	-	-	1	-
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	7	6	16	10	7	6
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	2	2	2	4	2	6
6.	Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	-	-	1	-	-
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	-	-	-	1	2	2
8.	Komisioni Mardhënieve me Jashtë	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	1	-	-	-	-
10.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale	1	1	1	1	1	2
11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	2	4	6	-	-	2
12.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-	-
13.	Komisioni i Politikave të	1	-	-	-	-	-

	Zhvillimit të Turizmit						
14.	Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
15.	<b>Totali 6 mujori II-të 144 raporte</b>	<b>20</b>	<b>18</b>	<b>37</b>	<b>31</b>	<b>15</b>	<b>23</b>

Nr.	Periudha	Raportet e Komisioneve të Përhershëm
1.	Totali 6 mujori I-rë	136
2.	Totali 6 mujori II-të	144
	<b>Totali 12 mujor</b>	<b>280 (p+r)</b>

*Sqarim : Mbledhjet e komisioneve janë më pak se raportet pasi komisioni ka bërë një mbledhje, por në atë mbledhje një komision ka shqyrtuar më shumë se 1 pikë sipas rendit të ditës dhe ka paraqitur raporte për secilën pikë që ka shqyrtuar.*

#### **Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:**

1. për probleme financiare - 51 vendime,
2. për probleme sociale - 14 vendime,
3. për infrastrukturën dhe strehimin - 55 vendime,
4. për problemet urbane dhe asetet - 8 vendime,
5. për emergjencat civile - 3 vendime,
6. për probleme të arsimit kulturës - 15 vendime,
7. të ndryshme - 20 vendime.

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, konkretisht me familjet përfituese në kuadër të procesit të rindërtimit apo dhe vendimet e prishjeve të shkollave, kopshtet, pallateve e shtëpiave individuale në qytet në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Durrës, të dëmtuara nga tërmeti me qëllim ndërtimet e tyre të reja nga fondi i rindërtimit akorduar nga Qeveria apo nga programi EU4Schols zbatuar nga UNDP.

**Vlen të përmendet fakti se gjatë këtij viti Këshilli Bashkiak miratoi plane e rregullore si më poshtë :**

1. Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës *me Vendim nr.24, datë 05.03.2021*
2. Disa kundravajtje administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Durrës *me Vendim nr.37, datë 31.03.2021*
3. Rregulloren për ngritjen, funksionimin e ndërveprimin e Strukturave Komunitare në Bashkinë Durrës *me Vendim nr.63, datë 24.05.2021.*
4. Kriteret, procedurat të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij *me Vendim nr. 82, datë 28.06.2021.*
5. Planin e Integritetit të Bashkisë Durrës *me Vendim nr.127, datë 28.10.2021.*
6. Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shorteut publik manual në Bashkinë Durrës në kuadër të rindërtimit *me Vendim nr. 138, datë 28.10.2021*
7. Ngritjen përbërjen dhe funksionimin e Këshillit Teknik Konsultativ pranë Bashkisë Durrës
8. Planin Social për Bashkinë 2021-2024 *me Vendim nr. 161, datë 23.12.2021*

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet)

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :

*Rreth Këshillit Bashkiak*

*Struktura e Këshillit Bashkiak*

*Anëtarët e Këshillit Bashkiak*

*Përbërja e Komisioneve*

*Konferenca e Kryetarëve*

*Legjislacioni*

*Rregulloret*

*Kalendari Mbledhjeve Të Këshillit*

*Njoftime (KB)*

*Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB*

*Procesverbalet e mbledhjeve të KB*

*Vendime të Këshillit Bashkiak*

*Konsultimet Publike*

*Regjistri i projekt akteve për konsultim publik të këshillit bashkiak*

*Raporte të Këshillit*

*Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti*

*Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare*

*Dëgjesa Publike*

*Pyetësor për Buxhetin 2022-2024*

Në zbatim të programit të transparencës do të hapen për vitin 2022 kartelat “Raporte të Komisioneve të Këshillit” dhe “Buxheti i Këshillit”.

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike ( *si në faqen zyrtare të Bashkisë, në media vendore, me email drejtuar OJF, Drejtorëve të bashkisë, Kryetarëve të Njësisve Administrative, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Durrës*) në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës.

Në protokollin e Sekretariatit kanë hyrë 158 shkresa zyrtare dhe kanë dalë 127 shkresa zyrtare. *(s qarojmë se disa shkresa nuk kanë patur nevojë për përgjigje pasi ka qenë për dijeni drejtuar kryetarit apo këshilltarëve, të cilëve sekretariati ia ka vënë në dijeni përmes postës elektronike apo aplikacioneve të tjera)*

Në zbatim të rregullores së miratuar me Vendim nr.103, datë 30.10.2020 është vënë në funksionim regjistri elektronik dhe fizik i ankesave/kërkesave dhe i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit.

Në Sekretariat si me shkresa dhe me email, janë dorëzuar 1 ankesë dhe 36 kërkesa, të cilave sekretariati në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit apo dhe ndonjë Komision i Përhershëm, i është përgjigjur, brënda afateve ligjore.

Forma e komunikimit ka qenë me email ose me postë.

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përcimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka hapur faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjerime nga qytetarë të ndryshëm. Katër mbledhje plenare të këshillit janë transmetuar direkt dhe nëpërmjet këtij rrjeti, ku komuniteti ka ndjekur direkt mbledhjen dhe ka dhënë mendimet për çështjet që janë shqyrtuar.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit u paraqitën në këshill “Raporte të Bashkisë Durrës” në zbatim të VKB nr.120, datë 24.12.2020. Do ishte e nevojshme një bashkëpunim dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin që të pregatisë në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara për vitin 2022 me VKB nr.148, datë 25.11.2021, por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Këshilli Bashkiak ka patur në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2021 :

Për zërin 602 – 50.000 lekë (kancelari, botime, kartolina, etj)

Për zërin 231 – 106.800 lekë (blerje kompjuter dhe printer për sekretarinë e këshillit), i cili u realizua në masën 100%.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 “Për konsultimin publik” gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, këshilli në bashkëpunim me bashkinë ka mundur të zhvilloj 5 dëgjesa publike, lidhur me miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 si dhe projekt buxhetin e vitit 2022 dhe PBA 2022-2024 të Bashkisë Durrës, në të cilat janë bërë pjesë diskutimi qytetarët e të gjithë njësisve administrative Manëz, Ishëm, Rrashbull, Katund i Ri, Sukth, lagjet në Bashkinë Durrës si dhe grupe interesi, ku morën pjesë 300 banorë. Vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e propozimeve nga komuniteti u reflektuan në buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2022.

Këshilli nëpërmjet faqes së tij online ka hapur një rubrikë të konsultimeve me publikun si një nga mënyrat e pjesëmarrjes së komunitetit për të përcjell shqetësimet e sygjerimet e tij. Dhe në këtë faqe publikohen të gjitha projektvendimet, që sipas ligjit para se të shqyrtohen kërkojnë seanca dëgjimore.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Punë të mbarë për vitin 2022 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Falenderimet gjithashtu shkojnë për....

- Falenderojmë për punën e palodhur administratën e Bashkisë Durrës dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në veçanti Drejtorinë Juridike, Kabinetin e Kryetarit, Drejtorinë Ekonomike, Komisionet apo Zyrën e Rindërtimit, Protokollin dhe Zyrën e Marrdhënieve me Publikun.
- Falenderojmë znj.Eneida Marku koordinatore e projektit “Bashki të Forta” si dhe mentoren Meliha Maloku për asistencën teknike dhe operacionale.